



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:020785
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05628045

Cap.nr.1279/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbarimore të kreditorit A.H. nga fsh. L., Komuna Istog, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z.G. avokat nga Istogu, kundër debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KEDS) në Pejë, Rr. "Mbretresha Teutë", nr.69, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, Ep.nr.51/22 të datës 08.05.2023, jashtë seance me datë 26.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KEDS) në Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, Ep.nr.51/22 i datës 08.05.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar Ep.nr.51/22 të datës 08.05.2023, në dispozitiv e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit KEDS Sh.a, me numër të biznesit ..., me adresë Rr. "Mbretresha Teutë", në Pejë, i parashtruar kundër urdhrorit të Përmbaruesit Privat Blerim Baloku P.nr.391/21 të datës 16.12.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, ashtu që të ndryshohet aktvendimi i atakuar, ose lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje dhe rigjykim me vërejtje si në ankesë.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori përmes të autorizuarve të tij, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues-aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.274/19 të datës 14.10.2020, i plotfuqishëm nga data 18.10.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 03.11.2021. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin e kërkuar nga kreditori me urdhrin P.nr.391/21 të datës 16.12.2021, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 21.12.2021. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimimit vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, organi përmbartues e cakton përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit përmbartues, organi përmbartues e cakton përmbartimin vetëm në bazë të titullit përmbartues sipas dispozitë së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, si dokument përmbartues është: *“vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese”*. Në rastin konkret titull përmbartues është aktvendimi i Gjykatës Themelore në aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.274/19 të datës 14.10.2020, i plotfuqishëm nga data 18.10.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 03.11.2021. Dokument përmbartues në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LPP-së është përcaktuar se: *“vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur para gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”*, dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me aktvendim siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit nuk mund ta pranoj pretendimin ankimor se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave përmbartimore pasi që nuk ka qartësuar valditetin e urdhrin përmbartimor sipas nenit 44 par.1 të LPP-së, sepse në rastin konkret në aktvendimin për përmbartimin është treguar dokumenti ekzekutiv që është vendimi gjyqësor i cekur si më lartë dhe i vulosur ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LPP-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Cap.nr.1279/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti